

“SKY ALBSLO GROUP” SHA

Adresa: Rruga Maliq Muça, Godina private, K. 1, Lagjja nr. 3 Durrës, Albania

KONTRATË

PËR DHURIMIN E AKSIONEVE TË SHOQËRISË “SKY ALBSLO GROUP” - SHA

Sot me datë 04/09/2012 (shtatë maj, dymijë e dytëmbëdhjetë):

1. Z. Remzi Hoti, i biri i Xhaserrit dhe i Sadies, i datlindjes 22.01.1967, lindur dhe banues Durrës, Lagjja nr. 13, rruga Bajram Curri, me karte identiteti nr.030610302; (në vijim **DHURUESI**)

Dhe

2. Z. Ajdin Sejdiu, i datëlindjes 21/09/1951, lindur në Grabanicë, Kosovë dhe banues në Tiranë, me adresë rruga: “Dëshmorët e 4 Shkurtit”, Tiranë, me pasaportë nr. 1170570894 lëshuar në datë 02/07/2009;
3. Driton Beshiri, i biri i Beshirit dhe i Elhemes, i datlindjes 26.06.1960, lindur në Mitrovicë, Kosovë dhe banues në adresë Shkëmbi Kavajës, Durrës, me pasaportë nr. 1008410573; (në vijim **PRANUESI**)

MEQENËSE

DHURUESI Z. Remzi Hoti zotëron 49 % të akioneve të shoqërisë “SKY ALBSLO GROUP” - sha, të barabarta me 1.715 (njëmijë e shtatënëqind e pesëmbëdhjetë) akione, me vlerë të përgjithshme 1.715.000 (njëmillion e shtatënëqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekë;

Shoqëria “SKY ALBSLO GROUP” - sha e regjistruar në regjistrin tregtar me NIPT L21919501O, me kapital të regjistruar prej **3.500.000 (Tre milion e pesëqind mijë)** lekë, i përbërë nga **3500 akione**, me vlerë 1.000 lekë/akcion, nga ku 1.785 (njëmijë e shtatënëqind e tetëdhjetë e pesë) akione, me vlerë të përgjithshme 1.785.000 (njëmillion e shtatënëqind e tetëdhjetë e pesë mijë) lekë, i **zotëron** z. Ajdin Sejdiu, **ndërsa** 1.715 (njëmijë e shtatënëqind e pesëmbëdhjetë) akione, me vlerë të përgjithshme 1.715.000 (njëmillion e shtatënëqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekë, i **zotëron** z. Remzi Hoti.

*Pala DHURUESE, Z. Remzi Hoti nëpërmjet kësaj kontrate, deklaron vullnetin e tij të plotë për të dhuruar **490 akione** të shoqërisë që përfaqësojnë 14 % të akioneve të shoqërisë tek:*

- Z. Ajdin Sejdiu 140 akione me vlerë të përgjithshme 140,000 (njëqind e dyzet mijë) lekë;

- Z. Driton Beshiri 350 aksione me vlerë të përgjithshme 350,000 (treqind e pesëdhjetë mijë) lekë;
- A) *Pala PRANUESE, Z. Ajdin Sejdiu* dhe z. Driton Beshiri, shprehin vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, për tu bërë pronar i **490 aksioneve**, të barabarta me **490.000 lekë**, që përfaqësojnë **14 %** të aksioneve të shoqërisë.

ATËHERË, duke marrë parasysh sa më lart, për të cilat palët janë dakort dhe nuk kanë pretendime, palët bien dakort si vijon:

NENI 1 PARASHTRIMET

1.1 Parashtrimet e mësipërme në këtë kontratë përfaqësojnë arësyet dhe vullnetin e lirë të palëve përsa i përket nënshkrimit të këtij akti.

NENI 2 OBJEKTI

1.1 Objekti i kësaj marrëveshje është dhurimi i 490 aksioneve me vlerë nominale 1000 lekë për aksion dhc që përfaqësojnë **14 %** të aksioneve të shoqërisë nga **DHURUESIT** tek **PRANUESIT** sipas kushteve vijuese:

1.2 Pas nënshkrimit të kësaj kontrate, shoqëria "SKY ALBSLO GROUP" - sha, do të përbëhet nga këta aksionerë:

1. Z. AJDIN SEJDIU, do të zotërojë **55 %** të aksioneve të shoqërisë të barabarta me 1925 (njëmijë e nëntëqind e njëzetë e pesë) aksione, me vlerë të përgjithshme 1,925,000 (njëmillion e nëntëqind e njëzetë e pesë mijë) lekë;
2. Z. Remzi Hoti do të zotërojë **35 %** të aksioneve të shoqërisë të barabarta me 1225 (njëmijë e e dyqind e njëzetë e pesë) aksione, me vlerë të përgjithshme 1,225,000 (njëmillion e dyqind e njëzetë e pesë mijë) lekë;
3. Z. Driton Beshiri do të zotërojë **10 %** të aksioneve të shoqërisë të barabarta me 350 (treqind e pesëdhjetë) aksione, me vlerë të përgjithshme 350,000 (treqind e pesëdhjetë mijë) lekë;

NENI 3 ÇMIMI

3.1 AKSIONET e përcaktuara në nenin 2 sa sipër, transferohen nga DHURUESIT tek PRANUESI *pa kundërshpërblim dhe pa asnje kusht*.

3.2 Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, pala PRANUESE e përbërë nga **Z. Ajdin Sejdiu**, bëhet titullare e ligjshme **4 %** të aksioneve të shoqërisë të barabarta me 140

(nëntëqind e dyzetë) aksione, dhe Z. Driton Beshiri bëhet titullare e ligjshme 10 % të aksioneve të shoqërisë të barabarta me 350 (treqind e pesëdhjetë) aksione;

NENI 4 GARANCIA

4.1 DHURUESIT deklarojnë se shoqëria "SKY ALBSLO GROUP" - sha, është një shoqëri që ushtron aktivitetin e saj ekonomik në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

4.2 Shoqëria është regjistruar pranë të gjitha autoriteteve kompetente në Republikën e Shqipërisë.

4.3 DHURUESIT deklarojnë se janë titullar të ligjshëm të aksioneve, objekt të kësaj Kontrate dhe gëzojnë të gjitha të drejtat për nënshkrimin e kësaj Kontrate dhurimi.

4.4 DHURUESIT deklarojnë se aksionet e shoqërisë "SKY ALBSLO GROUP" - sha, janë të lira nga çdo barrë a pretendim tjetër ligjor i të tretëve mbi to.

4.5 DHURUESIT deklarojnë se shoqëria ushtron aktivitetin e saj në përputhje me të gjitha ligjet dhe aktet e tjera normative në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe nuk janë në dijeni të ndonjë fakti apo akti që mund të kundërshtojë këtë deklarim.

4.6 DHURUESIT deklarojnë se gjendja financiare e shoqërisë është në përputhje të plotë me deklarimet e kryera në Pasqyrat Financiare të shoqërisë dhe se shoqëria nuk ka detyrime apo marrëveshje që nuk janë pasqyruar në Pasqyrat Financiare apo librat e shoqërisë, të cilat mund t'i shkaktojnë shoqërisë ndonje efekt material negative. Me efekt material negative do të kuptohet çdo ngjarje e cila rrezikon ose rëndon në mënyrë thelbësore kryerjen normale të aktivitetit të shoqërisë. Të gjitha Pasqyrat Financiare dhe librat e shoqërisë, janë mbajtur në përputhje me ligjin dhe janë të vërteta dhe të rregullta.

4.7 DHURUESIT deklarojnë se nuk kanë detyrime ligjore të papaguara ndaj shoqërisë.

4.8 DHURUESIT deklarojnë se shoqëria nuk është në proces falimentimi apo likuidimi dhe ata nuk kanë dijeni të procedurave të hapura të falimentimit apo likuidimit apo të trethanave të cilat mund të shkaktojnë hapjen e këtyre procedurave.

NENI 5 TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE

5.1 Pas nënshkrimit të kësaj Kontrate, PRANUESI i dhurimit detyrohet të depozitojnë një kopje të kësaj Kontrate pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për të bërë ndryshimet përkatëse që lidhen me zotërimin e aksioneve të shoqërisë "SKY ALBSLO GROUP" - sha, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5.2 Palët bien dakort ta trajtojnë si të dhënë konfidenciale nënshkrimin e kësaj marrëveshje dhe të mos përhapim tek të tretë përbajtjen e kushteve të saj pa miratimin me shkrim të Dhuruesit.

NENI 6
TË NDRYSHME

6.1 Kjo marrëveshje përbën marrëveshjen e plotë midis palëve dhe zevendëson çdo kontratë të mëparshme, gojore apo me shkrim të palëve mbi këtë çështje. Asnjë shtesë apo ndryshim i parashikimeve të kësaj akt marrëveshje nuk do të jetë e detyrueshme për palët, përvçëse kur bëhet me shkrim dhe nënshkruhet rregullisht nga palët.

6.2 Të gjitha njoftimet në lidhje me këtë akt marrëveshje do të bëhen me shkrim dhe do te konsiderohen si të njoftuarë në momentin e marrjes së tyre. Këto njoftime, mund të jepen dorazi, me postë të autorizuar, me shërbim postar që garanton dorëzimin.

Në çdo rast, njoftimet kryhen në adresat përkatëse që palët kanë deklaruar në këtë marrëveshje.

6.3 Kjo marrëveshje përpilohet në katër kopje, me vlerë të njëjtë ligjore, në gjuhën shqipe.

6.4 Kjo marrëveshje rregullohet dhe interpretohet sipas ligjeve në Republikën e Shqipërisë. Për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e kësaj Kontrate, kompetente do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kjo marrëveshje, pasi u lexua nga palët dhe pasi u gjet konformë vullnetit të plotë të tyre, u nënshkrua rregullisht dhc pa vërejtje.

Tiranë, më 04/09/2012



DHURUESI

Remzi HOTI



PRANUESIT

Ajdin SEJDIU


Driton BESHIRI


Organj kompetent qđ iščeh pasaporten
Hodnešnje opred koju izdaje nacoli
Passport-issuing authority


3

FASAFIRU - FASOFI - PASSPORT KOSOVA - KOSOVO

卷之三

Moral Judgment

NAME		TYPE OF PASSPORT	
SEJDU AJDIN		P HOLDING	
NATIONALITY / PLACE OF BIRTH		ISSUE NUMBER	
ALBANIAN, TIRANA, 01.01.1984		KOC286145	
SEX		EXPIRATION DATE	
M		01.07.2019	
DATE OF ISSUE		ISSUING AUTHORITY	
02.07.2009		MINISTRY OF INTERNAL AFFAIRS - PHOTINA	
SIGNATURE		01.07.2019	



I<ALB0306103027670122171D<<<<
6701228M2101255ALB<<<<<<<<<8
HOTI<<REMZI<<<<<<<<<<<<

Remzi Helim

P J S H

